



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO QEVERIA E KOSOVËS-VLADA / GOVERNMENT OF KOSOVO	
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE I TEKNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	5
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	2
Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	1068
Data: Datum Date	29.09.2022
Prishtinë / a	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 29-09-2022
Nr. 5/1068

Komisioni për licencimin e BPrAL, në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 dhe në bazë të neneve 5, 6, 7, dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë, shqyrtoi kërkesat nr. 1068 të datës 18.05.2022 dhe nr. 1068 e datës 06.07.2022 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “UNIVERSUM” dhe mori këtë :

V E N D I M

1. Licencohet BPrAL/Kolegji “UNIVERSUM” në kampusin kryesor në Prishtinë sipas vendimit ref. 651/22 i datës 16.05.2022 dhe dega në Ferizaj sipas vendimit ref. 677/22 i datës 26.05.2022 për periudhën pesë vjeçare 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027.
2. Licencohen programet e studimit në bazë të vendimeve nr. 3036/21, datë 12.08.2021, nr. 951/22, datë 18.07.2022 dhe vendimit nr. 972/22, datë 22.07.2022.
3. Nuk licencohen programet e studimit: Fizioterapi, Bachelor Profesional, 180 ECTS dhe Infermieri, BSc, 180 ECTS, dega në Ferizaj.
4. Nuk licencohet programi i studimit: Diplomaci. MA 120 ECTS
5. Kërkesa nr. 1068 datë 06.07.2022 dhe dokumentit “sqarim...” nr. 1815, datë 26.07.2022, për lejin e transferit të nxënësve / studentëve të Programit Infermieri Pearson (Niveli V) në programin e studimeve Infermieri BSc (Niveli VI), i lejohet brenda numrit 50 të studentëve në bazë të vendimit për Akreditim 3036/21, i datës 12.08.2021 nga AKA.
6. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, Komisioni për licencim të BPrAL të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesave nr. 1068 të datës 18.05.2022 & nr. 1068 e datës 06.07.2022 të parashtruar nga Kolegji

“UNIVERSUM”, vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim sipas pikës 1 të këtij vendimi.

Duke u bazuar në pikën 1 të vendimit nr. ref.651/22 i datës 16.05.2022, lëshuar nga Agjencioni i Kosovës për Akreditim kërkesa e kolegjit “UNIVERSUM” merret si e bazuar nga ana e komisionit për licencim duke e licencuar këtë institucion të Arsimit të Lartë Privat për periudhën pesë vjeçare 1 tetor 2022 deri me 30 shtator 2027.

Licencohen programet e studimit sipas pikës 2 në bazë të vendimeve nr. 3036/21, datë 12.08.2021, nr. 951/22, datë 18.07.2022 dhe vendimit nr. 972/22, datë 22.07.2022.

Institucioni në fjalë duhet të paraqes kërkesë për licencim të programeve të studimit tek Komisioni për licencim të BPrAL, sipas vendimit nr. 3036/21, datë 12.08.2021.

Ndërkaq pika 3 dhe 4 e këtij vendimi, nuk i japin të drejtën e zhvillimit të programeve të cekura duke patur parasysh se ky institucion nuk ka fituar procesin e akreditimit nga ana e AKA-së.

Gjithashtu, sipas pikës 5 të këtij vendimi bazuar në kërkesën nr. 1068 datë 06.07.2022 dhe dokumentit “`sqarim....” nr. 1815, datë 26.07.2022 për lejimin e transferit të nxënësve/ studentëve të Programit Infermieri Pearson (Niveli V) në programin e studimeve Infermieri BSc (Niveli VI), i lejohet brenda numrit 50 të studentëve sipas vendimit për Akreditim 3036/21, i datës 12.08.2021 nga AKA. Konkreisht sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe UA, nr. 16/2014, datë 06.05.2014, Neni 7, pika 6 dhe Neni 8, pika 2, si dhe Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve në Kosovë, e cila e rregullon çështjen e transferimit.

Komisioni për licencim i MASHTI-t, duke marrë parasysh faktet e ofruara në dokumentacionin për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, te Sekretari i Përgjithshëm i MASHTI-t.

Vendimi u dërgohet:

1. Parashtruesit të kërkesës;
2. Sekretarit të përgjithshëm në MASHTI;
3. Departamentit të arsimit të lartë në MASHTI;
4. Inspektoratit të Arsimit;
5. Arkivit.

Kryetar i Komisionit
Burim Gashi

